



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402164/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për llogaritjen e diferencës së pensionit të pleqërisë dhe dhënien e shumës përkatëse shtetasit N.K.*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

D U R R Ë S

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi N.K, lidhur me mospërfitimin e diferencës së pensionit të pleqërisë.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë, ankuesi ka përfituar pension të plotë të pleqërisë më datë 03.05.2000. Masa e pensionit që ka gëzuar ky shtetas ka qenë llogaritur më e ulët se sa i takonte të përfitonte, bazuar në vjetërsinë e punës dhe kontributet e derdhura.

Pas rillogaritjes së pensionit të pleqërisë, masa e pensionit u rrit dhe që nga muaji Tetor 2014, ka marrë pension më të lartë.

Pavarësisht rritjes së masës së pensionit, ankuesi nuk ka marrë diferencat që i takojnë të pensionit të pleqërisë, pas rillogaritjes përkatëse.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Bazuar në nenin 62 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pika 3, thuhet shprehimisht se

"Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet".

Nga sa rezulton ankuesi e përfituar rritjen e pensionit mujor të pleqërisë, por nuk ka marrë ende diferencat përkatëse për periudhën tre vjeçare të përcaktuara në ligj.

Për sa më sipër, me qëllim që ankuesi të përfitojë të drejtat e tij ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për llogaritjen e diferencës së pensionit të pleqërisë dhe dhënien e shumës përkatëse shtetasit N.K.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI